Ministria e Drejtësisë
Departamenti për Administrimin e Burgjeve

Karta
e të Drejtave dhe Detyrave
të të Burgosurve dhe të
Internatëve

(Lingua Albanese)

Decreto del Ministro della Giustizia del 5 dicembre 2012

Me dekret të Ministrit të Drejtësisë të 5 dhjetorit të 2012, është vendosur përmbajtja e **"Kartës së të Drejtave dhe Detyrave të të Burgosurve e të Internatëve"** siç parashikohet në normativën *art. 69 comma 2 DPR 30 giugno 2000, n. 230* (Rregullore që përmban normativën e burgjeve e mbi masat që heqin apo kufizojnë lirinë) siç është e modifikuar nga *DPR 5 giugno 2012, n. 136.*

PËRMBAJTJA

Karta e të Drejtave dhe Detyrave
të të Burgosurve e të Internatëve ..... fq 4

Fjalor (dokumenti i bashkëngjitur n. 1)..... fq 19
Burimet juridike (dokumenti

i bashkëngjitur n. 2) .....fq 38

Karta e të Drejtave dhe Detyrave të të Burgosurve e të Internatëve[1]

Karta e të Drejtave dhe Detyrave të të Burgosurve e të Internatëve parashikohet nga Rregullorja që përmban normativën e burgjeve e mbi masat që heqin apo kufizojnë lirinë. Kjo Kartë i dorëzohet çdo të burgosuri apo internati, gjatë takimit me drejtorin apo me një nga nënpunësit e burgut në momentin kur do të hyjë në strukturë, për t'i dhënë mundësinë të ushtrojë në mënyrë të përshtatshme të drejtat e tij e për të qenë i vetëdijshëm mbi rregullat që përkufizojnë jetesën në burg.

Për t'i dhënë mundësinë familjarëve të njohin Kartën, ajo do të publikohet në internet në adresën http://www.giustizia.it dhe një kopje do jetë në dipozicion për t'u lexuar në sallën e takimeve të çdo strukture të burgjeve. Të burgosurit, përveç Kartës, do t'i dorëzohet dokumenti përmbledhës i normativës *legge 26 luglio 1975, n. 354* (Normativa e burgjeve e mbi marrjen e masave që heqin apo kufizojnë lirinë), *decreto del Presidente della Repubblica 30 giugno 2000, n. 230* (Rregullorja që përmban normativën e burgjeve e mbi masat që heqin apo kufizojnë lirinë), i Rregullores së brendshme të burgut e të dispozitave të tjera ligjore, edhe mbikombëtare, mbi të drejtat e detyrat e të burgosurit apo të internatit, mbi disiplinën e trajtimin

[1] Shih fjalorin

në burg, si p.sh. Konventa Evropiane për brojtjen e të drejtave të njeriut e të lirive themelore. Njëkohësisht tregohet edhe ku mund të lexohen tekstet e plota të ligjeve të sipërpërmendura[2].

Hyrja në burg

Hyrja në strukturën e burgut kryhet nga personeli i policisë së burgjeve i Zyrës së regjistrimin. I burgosuri ka **të drejtë të njoftojë të afërmit e tij**, si në rastin kur hyn nga gjendja e lirisë si në rastin kur transferohet nga një burg tjetër. I burgosuri ka të drejtë të emërojë një o dy avokatë mbrojtës të besuar (në mungesë të të cilit magjistrati do të emërojë një avokat të shtetit). I burgosuri ka të drejtë **të ketë takime me avokatin e tij** që nga momenti kur hyn në burg e gjatë gjithë periudhës që do të qëndrojë, në oraret e sipas kushteve të vendosura pasi ka paraqitur kërkesë tek Zyra e Regjistrimit, përveç rastit kur autoriteti gjyqësor në momentin e arrestit vendos të kundërtën (për jo më tepër se 5 ditë). Të burgosurit do t'i **merren shenjat e gishtave, do të kontrollohet** e duhet **të dorëzojë paratë, orën e dorës, rripin dhe sendet me vlerë**. Po ashtu duhet edhe të bëjë **vizitën mjekësore e psikologjike** gjatë së cilës mund të parashtrojë problemet shëndetësore që mund të ketë si dipendencat (p.sh. toksikomani), intollerancat (p.sh.

[2] Riferimenti i ligjeve (nenet, paragrafet, shkronjat) do të bëhet në italisht për të lehtësuar gjetjen e tyre në tekstet ligjore italiane e do të dallohet nga shkrimi *kursiv* si edhe çdo citim në italisht.

ushqimore), dhe nevojshmërinë për të marrë ilaçe. **I burgosuri mund të kërkojë të mos qëndrojë** me të burgosur të tjerë për arsye vetësigurie.

Jeta e përditshme:

Burgjet duhet të kenë ambiente të përshtatshme për jetësën individuale e ambiente ku të zhvillohen aktivitetet e përbashkëta me sipërfaqe të mjaftueshme, të ajrosura, të ngrohura e me shërbime higjenike të veçuara. I burgosuri ka të drejtë të ketë të mbathura, veshje, shtresa e mbulesa për krevatin për të cilat duhet të ketë kujdes si edhe duhet të mbajë pastër qelinë e të kujdeset për veten. Garantohet përdorimi i dushit dhe prerja e rruarja e mjekrës periodikisht. Çdo i burgosur apo internat ka **të drejtë të dalë në ajrim** në ambiente të hapura për të paktën dy orë në ditë ose, në gjendje burgimi të veçanta, për një kohë më të shkurtër, por jo më pak se një orë në ditë. Të burgosurit apo internatët kanë të **drejtë të kenë ushqim të përshtatshëm për shëndetin** apo për kushtet shëndetësore vetjake. Kanë të drejtë ushqimi për tre vakte, të shpërndara sipas orareve të përcaktuara nga instituti. Kanë të drejtë të kenë ujë të pijshëm e të përdorin, duke respektuar rregullat e sigurisë, një furnellë personale. Po ashtu të burgosurit i lejohet blerja, me shpenzimet e veta, e prodhimeve ushqimore apo suplementare (që quhet *sopravvitto*), si edhe sigurohet e drejta për t'u furnizuar nga jashtë me pako, me mallrat e lartpërmendura brenda një peshe të caktuar. Një grup përfaqësuesish e

të burgosurve kontrollojnë përgatitjen e ushqimeve dhe çmimin e mallrave të shitura në burg. Garantohen **e drejta shëndetësore** dhe shërbimet bazë e të përshtatshme të parandalimit, diagnostikimit, shërimit e riaftësimit. Shërbimet në dispozicion brenda çdo burgu përshkruhen në Kartën e shërbimeve shëndetësore për të burgosurit e internatët. Të burgosurve dhe internatëve u njihet **e drejta për të ushtruar besimin e tyre fetar**, e mbështetjes shpirtërore të kapelanit (priftit) katolik e për të marrjë pjesë në ritet fetare në kapelat katolike apo në ambjentet e dedikuara feve jo katolike.

Detyrat e të burgosurve e internatëve:

Të burgosurit duhet të respektojnë normat e burgut e në mënyrë të veçantë, udhëzimet e personelit të policisë së burgjeve. Shkeljet e disiplinës (ndër të cilat mos mbajta e pastërtisë dhe e rregullit, moskryerja e vetëdijshme e punës së detyruar, mbajtja apo trafiku i sendeve të ndaluara si e parave apo e mjeteve offenduese/lënduese, komunikimi me jashtë apo brenda institutit me mashtrim, kanosjet, padrejtësitë, vonesa në kthimin në burg e të gjitha veprimet që ligji i trajton si shkelje) do të ndëshkohen, në raport me rëndësinë që kanë, me qortim, paralajmërim, përjashtim nga aktivitetet sportive (për jo më shumë se dhjetë ditë), izolimi gjatë daljes në ajrim (për jo më shumë se dhjetë ditë) e përjashtimi nga aktivitetet e përbashkëta (për jo më shumë se pesëmbëdhjetë ditë). I

burgosuri është i detyruar t'i nënshtrohet kontrollit për arsye sigurie çdo herë që të jetë e nevojshme. Ka **të drejtë të mos vuajë masa shtrëngimi fizik për arsye disiplinore (si p.sh. përdorimin i prangave)** e mund të paraqesë **ankesë** tek magjistrati i mbikëqyrjes lidhur me kushtet e ushtrimit të pushtetit disiplinor. Në vija të përgjithshme, i burgosuri mund të paraqesë **ankesë** tek magjistrati i mbikëqyrjes për të kërkuar të drejtat e tij që njihen nga ligji e mund t'i drejtohet për çdo lloj ankese drejtorit të burgut, inspektorëve, Ministrit të Drejtësisë, magjistratit i mbikëqyrjes, autoriteteve gjyqësore e shëndetësore që vizitojnë burgun, Presidentit të Këshillit Krahinor (*Giunta Regionale*) dhe Presidentit të Republikës.

Arsimimi e aktitivitetet kulturore, sportive e sbavitëse:

Në strukturat e burgjeve zhvillohen kurse shkollore të arsimimit të detyrueshëm e të shkollës së mesme. Të burgosurit mund të përfitojnë një ndihmë ekonomike ditore, në masën e parashikuar me dekret ministerial, për frequentimin e kurseve të nivelit të mesëm. Të burgosurve që ndjekin kurse të shkollës së mesme apo kurse universitare të cilët kanë kaluar të gjitha provimet e çdo viti, nëse janë në gjendje ekonomike të vështirë, do t'u kthehen të gjitha shpenzimet e bëra për taksat, kuotat shkollore dhe librat, si edhe u jepet një shpërblim për rendimentin e mirë shkollor. Të burgosurit që dallohen për zell e rezultate pozitive në

kurset shkollore apo përgatitjen profesionale do të shpërblehen. Është e mundur edhe përgatitja e provimeve vjetore apo atyre për marrjen e diplomës së shkollës së mesme apo universitare (si privatist – pa qenë i pranishëm gjatë vitit shkollor). Burgjet kanë biblioteka që drejtohen nga vetë të burgosurit. Hyrja në ambietet e bibliotekës kryhet në ditët e oraret e përcaktuara nga rregullorja e brendshme e burgut. Në strukturën e burgut organizohen aktivitete kulturore, sportive e zbavitëse si pjesë e trajtimit riedukativ. Organizimi i këtyre aktiviteteve kryhet nga një komision i përbërë nga drejtori, nga një o më shumë edukatorë, nga një o më shumë asistentë socialë e nga një grup përfaqësues i të burgosurve. Për të marrë pjesë në kurset shkollore apo në aktivitetet e tjera është e mjaftueshme të paraqitet një kërkesë me shkrim. Gjatë ajrimit në ambientet e hapura, të burgosurit mund të kryejnë aktivitete sportive.

Puna:

Puna është një nga elementet themelorë të trajtimit gjatë vuajtjes së dënimit. Të burgosurit pasi kanë paraqitur kërkesë për të punuar, mund të zhvillojnë punën brenda burgut (si guzhinier, berber, magazinier etj.) ose jashtë burgut. Puna jashtë burgut është një mënyrë ekzekutuese e dënimit: për të dënuarit për vepra penale ordinere ekzekutimi nuk ka kufizime, për të dënuarit për vepra penale të veçanta puna mund të

zhvillohet mbasi është vuajtur 1/3 e dënimit dhe mbas 10 vjetësh për të dënuarit me burgim të përjetshëm.
Magjistrati i mbikëqyrjes aprovon vendimin e Drejtorit të burgut dhe jep udhëzimet e rastit. Të burgosurit e internatët që i nënshtrohen masave të sigurisë të kolonisë bujqësore e të shtëpisë së punës janë të detyruar të punojnë. Shpërblimi përcaktohet në një masë jo më të ulët se dy të tretat e shumës së parashikuar nga kontratat kolektive të punës përkatëse.

Shpërblimi:

Të burgosurit e internatët që dallohen për angazhimin në punë e në studim, për ndihmën që i japin të tjerëve o për veprimtari të lëvdueshme, do të shpërblehen me lavdërim nga drejtori e me propozimin – që do të paraqitet nga komisioni i disiplinës – për falje, liri të kushtëzuar, revokim të parakohshëm të masave të sigurisë etj.

Transferimi:

Kërkesat për transferim duhet të paraqiten, me anë të drejtorit të burgut, tek Përgjegjësi Krahinor (Provveditore regionale), nëse transferimi kërkohet për një burg që i përket të njejtës zonë kompetence, ose tek Departamenti për Administrimin e Burgjeve (*Dipartimento dell'amministrazione penitenziaria*) e Ministrisë së Drejtësisë, nëse transferimi kërkohet për një burg jashtë kësaj zone. Afërsia e burgut me vendbanimin e të afërmve e të burgosurit është një

kusht që lehtëson pranimin e kërkesës së transferimit. Të burgosurit kanë të drejtë të mos transferohen, përveçse për arsye të rënda e të verifikuara sigurie, për nevojat e burgut apo për arsye drejtësie.

Kursimet/shumat e parave dhe raportet ekonomike me insitucionet:

Ndalohet mbajtja e parave; shuma e parave që i burgosuri ka me vete në momentin kur hyn në strukturën e burgut dhe ato që do të marrë me postë apo me dorëzim në portineri (*peculio*) do të depozitohen e do të jenë në dispozicion të të burgosurit për blerjen e mallrave, për korispondencën me postë apo për komunikimet telefonike. I burgosuri është i detyruar të paguajë shpenzimet e ndenjes, duke përfshirë vaktet e ngrënies, përdorimin e ndërresave e mbulesave të furnizuara nga administrata e burgut (dysheku, çarçafët, piatat, lugët e pirunjt etj.). Me kërkesë të të burgosurit, magjistrati i mbikëqyrjes mund të vendosë të shlyejë borxhin në rast vështirësie ekonomike e nëse mbahet sjellje shëmbullore.

Marrëdhëniet me jashtë:

Të burgosurit e internatët kanë të drejtë të **takojnë** të afërmit (apo persona të tjerë kur është e arsyeshme), dhe me avokatin mbrojtës e garantuesin e të drejtave të të burgosurve. Gjatë takimit, që zhvillohet në ambiente pa ndarje e nën kontroll viziv por pa u dëgjuar nga personeli i policisë së burgjeve, i burgosuri duhet të

mbajë një qëndrim të rregullt, përndryshe mund t'i mohohet e drejta e takimeve. Çdo i burgosur ka të drejtë të ketë gjashtë takime në muaj, për jo më shumë se një orë e me jo më shumë se tre veta për çdo takim. I burgosuri ka të drejtë, po ashtu, te ketë **biseda telefonike** me të afërmit apo bashkëjetuesit, e në raste të veçanta (të arsyeshme) me persona të tjerë; këto biseda lejohen një herë në javë për jo më shumë se 10 minuta, si edhe mbas kthimit në strukturë kur ka dalë me leje apo autorizim. Shpenzimet janë në ngarkim të të burgosurit. Për kushte të veçanta burgimi, rregullat mund të jenë më kufizuese. Kërkesa i duhet paraqitur, përsa i përket personave nën hetim, Autoritetit Gjyqësor kompetent; ndërsa përsa i përket të dënuarve (edhe me dënim të shkallës së parë) e për internatët, kërkesa i paraqitet drejtorit të burgut.

Korrispondenca (postare) mund të merret në burg pa kufizime për burgimin në kushte të zakonshme; letrat që i burgosuri i drejton avokatit mbrojtës, antarëve të Parlamentit, përfaqësive diplomatike o konsullore të vendit të tij, organizatave që mbrojnë të drejtat e njeriut nuk mund të kufizohen në asnjë mënyrë. Çdo i burgosur ka të drejtë të marrë katër pako në muaj prej jo më shumë se 20 kg, gjatë takimeve, apo me postë kur nuk ka patur takime për pesëmbëdhjetë ditë. Garantohet mbajtja e **marrëdhënieve familjare**. Të afërmve u njoftohet transferimi nga një strukturë në tjetrën. I burgosuri ka të drejtë të caktojë të afërmit që dëshëron të informojë menjëherë në rast vdekjeje apo

sëmundjeje të rëndë si edhe për të cilët dëshëron të ketë po të njëjtat informacione. Të burgosurit kanë **të drejtë të votojnë**, me rastin e votimeve, në seli të veçanta, kur kanë paraqitur kërkesë tre ditë para votimeve të Kryebashkiakut të vendit ku ndodhet burgu. Lejohet përdorimi i një radioje si edhe i kompjuterit apo lexuesit për dvd për arsye studimi apo pune.

Mënyra shpërblyese:

Lejet: lejet janë pjesë përbërëse e programit të trajtimit, sepse japin mundësinë të zhvillohen interesa emocionale, kulturore e ato për të punuar. Magjistrati i mbikëqyrjes mund të autorizojë leje për të dënuarit që nuk paraqesin rrezikshmëri për shoqërinë, nëse kanë mbajtur një sjellje të rregullt dhe kanë vuajtur një pjesë të mirë të dënimit. Lejet, që jepen si çmim, nuk mund të zgjasin më tepër se 15 ditë e nuk mund mund të tejkalojnë 45 ditët brenda vitit. Janë vendosur rregulla kufizuese o përjashtime për rastet e të dënuarve për krime të rënda apo për ata që janë arratisur o të cilëve u është revokuar një masë alternative. Në rast rreziku jete për një të afërm apo bashkëjetues, gjykatësi i procedimit apo magjistrati i mbikëqyrjes mund t'i japë leje të hetuarve apo të dënuarve për t'i bërë visitë të sëmurit. I dënuari që pa arsye të forta nuk rikthehet në burg në përfundim të lejes do të ndëshkohet me masa disiplinore nëse mungesa zgjat nga tre deri në 12 orë; në rastet e tjera do të trajtohet e ndëshkohet si vepër penale që përshkruhet si arratisje. Në rast se kërkesa

për leje mohohet, i burgosuri mund të bëjë ankesë brenda një kohe shumë të shkurtër.

Lirimi para afatit: Magjistrati i mbikëqyrjes mund t'i japë të burgosurve të dënuar lirimin para afatit të caktuar, që përcaktohet me një ulje të vuajtjes së dënimit prej 45 ditësh për çdo 6 muaj të kaluara në burg. Ky privilegj i takon vetëm të burgosurve që kanë mbajtur sjellje të rregullt e që kanë marrë pjesë në aktitvitetet e mbikëqyrjes e të trajtimit. Është e vlefshme edhe periudha e arrestit në shtëpi apo burgimit parandalues. Mund të autorizohet i njëjti trajtim në kushtet e lartpërmendura edhe për ata që janë në kujdestari në provë tek shërbimet sociale. Në kundërshtim me vendimin e marrë nga magjistrati i mbikëqyrjes mund të paraqitet ankesë që parashtron arsyet pranë Gjykatës së mbikëqyrjes brenda 10 ditësh nga njoftimi i hedhjes poshtë të kërkesës së lirimit para afatit.

Masa të kufizimit të lirisë të ndryshme nga burgimi:

Kujdestaria në provë tek shërbimet sociale:

Nëse dënimi apo periudha e mbetur për t'u vuajtur është më e shkurtër se 3 vjet, i dënuari, në bazë të rezultateve të mbikëqyrjes/vrojtimit të personalitetit, mund të lihet nën kujdestarinë e shërbimeve sociale për periudhën e vuajtjes së dënimit që mbetet, gjatë të cilës do të ndiqet nga Zyra e eksekutimit penal të jashtmëm (UEPE). Kërkesa e kujdestarisë i drejtohet magjistratit

të mbikëqyrjes e masa e kujdestarisë mund të merret nga gjykata e mbikëqyrjes. Kur gjykata e mbikëqyrjes në fjalë, vërteton rezultatet pozitive të periudhës së kaluar nën kujdestari, deklaron mbarimin e vuajtjes së dënimit e të çdo rrjedhoje penale të dënimit. Personi me toksikomani e/o alkoolist, me dënim apo me mbetje të dënimit për t'u vuajtur nën 6 vjet (4 vjet për krime të veçanta), që është duke ndjekur një program riaftësimi apo që do t'i nënshtrohet një programi të tillë (në bashkëpunim me shërbimin për toksikomanitë të *AUSL*-it – shërbimi sanitar lokal – përkatës) mund të përfitojë kujdestarinë "terapeutik". Masa e kujdestarisë nuk mund të jepet më shumë se dy herë.

Burgimi në shtëpi:

Gjykata e mbikëqyrjes mund të autorizojë burgimin në shtëpi për personat që kanë mbushur moshën 70 vjeç, nëse i dënuari nuk është deklaruar kriminel i zakonshëm, profesionist apo me prirje kriminale e që ka përsëritur rregullisht vepra penale. Mund të përfitojnë të njëtin trajtim ata që janë dënuar o u mbetet për t'u vuajtur një dënim nën 4 vjet, gratë shtatëzëna, nëna o babai me fëmijë me të cilët bashkëjeton me moshë nën 10 vjeç, personat në kushte shëndetësore të veçanta apo personat me moshë mbi 60 vjeç (kur janë invalidë) ose nën 21 vjeç; personat me dënim apo me periudhë të mbetur për të vuajtur më të shkurtër se 2 vjet.

Ekzekutimi në shtëpi i dënimit me burgim prej jo më shumë se 18 muajsh:

Përveç rasteve të lartpërmendura, ligji parashikon që dënimet që nuk kalojnë periudhën prej 18 muajsh – edhe kur bëhet fjalë për mbetjen e një dënimi më të gjatë – të kryhen në shtëpi apo në një vendbanim tjetër, përveçse në rastin e të dënuarve për krime të rënda që i përkasin normativës *art. 4 bis della legge n. 354/75* (shih fjalorin). Nënat me fëmijë nën 10 vjeç, në rast se kanë vuajtur një të tretën e dënimit (15 vjet kur bëhet fjalë për dënim me burgim të përjetshëm), mund të vuajnë dënimin në shtëpi nëse mund të rivendoset bashkëjetesa me fëmijët.

Gjysëmliria:

Gjysëmliria është një masë që i lejon të dënuarit të kalojë një pjesë të ditës jashtë burgut për të punuar, studiuar o sidoqoftë për aktivitete që janë të nevojshme për rikthimin në shoqëri. Kjo masë autorizohet nga gjykata e mbikëqyrjes për ata që:

- i nënshtrohen një mase siguruese;
- janë dënuar me arrest apo burgim për jo më shumë se 6 muaj;
- janë dënuar me më shumë se 6 muaj e kanë vuajtur gjysmën e dënimit (2/3 për krimet më të rënda siç përshkruhen në normativën e burgjeve *art. 4 bis, comma 1 O.P.*;
- janë dënuar me burgim të përjetshëm e kanë vuajtur 26 vjet burg.

Liria e kushtëzuar:
Liria e kushtëzuar mund t'i jepet atyre që kanë vuajtur të paktën 30 muaj burgim, o të paktën gjysmën e dënimit të vendosur, nëse pjesa mbetëse e dënimit për t'u vuajtur nuk kalon 5 vjetët (për përsëritësit e veprave penale të paktën 4 vjet të vuajtura por jo më pak se 3/4 e dënimit; në rast burgimi të përjetshëm, duhet të jenë vuajtur të paktën 26 vjet burgim). Për të përfituar lirinë e kushtëzuar duhet të jetë mbajtur, gjatë periudhës së vuajtjes së dënimit në burg, një sjellje që të jetë garanci për marrjen e kësaj mase. Liria varet nga përmbushja e detyrimeve civile që rrjedhojnë nga vepra penale, përveçse kur është e pamundur.
Pezullimi i ekzekutimit të vuajtjes së dënimit për toksikomanët e alkoolistët:
Gjykata e mbikëqyrjes mund të pezullojë ekzekutimin e vujajtjes së dënimit për 5 vjet për ata që duhet të vuajnë një dënim apo mbetjen e një dënimi prej jo më tepër se 6 vjetësh (4 vjet për dënime për vepra penale të veçanta) për veprat penale të kryera në gjendje alkoolizmi apo toksikomanie e që i janë nënshtruar me sukses një programi terapeutik e socio-rehabilitativ në një strukturë publike apo të autorizuar siç përshkruhet nga ligji.

Burgimi në kushte të veçanta:

Mbikëqyrje speciale:
Mbikëqyrja speciale mund të vendoset nga Departamenti për Administrimin e Burgjeve (me

iniciativën e vet apo me sugjerim të drejtorit ose të autoriteteve gjyqësore, me miratimin e këshillit disiplinor) në lidhje me sjelle agresive ndaj rendit e sigurisë në strukturën e burgut. Kjo masë sjell kufizime të veçanta lidhur me të drejtën për të punuar apo për të marrë pjesë në në aktivitetet e zakonshme, në marrjen e postës apo telefonatave, mbajtjen e sendeve zakonisht të lejuara. Kufizimet nuk mund të kryhen në lidhje me higjenën nevojat shëndetësore, ushqimin, veshjen e mbulesat, leximin e librave e gazetave, ushtrimin e besimit/fesë, përdorjen e radios së llojit të lejuar, ajrimin në ambjente të hapura për të paktën një orë në ditë, takimet me avokatët si edhe me bashkëshortin/en, bashkëjetuesin/en, fëmijët, prindërit e vëllezërit. Në kundërshtim me vendimin e marrë nga Departamenti për Administrimin e Burgjeve mund të paraqitet ankesë tek gjykata e mbikëqyrjes brenda 10 ditësh.

Burgimi për të dënuarit për krime të veçanta:

Të dënuarit apo internatët për krime veçanërisht të rënda të renditura në *art. 4 bis l. 354/1975* (shih fjalorin) mund të përfitojnë vetëm katër takime e 2 telefonata në muaj e pësojnë kufizime në aplikimin e privilegjeve lidhur me caktimin e punës jashtë burgut e të pjesëmarrjes në aktivitetet kulturore e sportive, të lejeve shpërblyese e të masave alternative.

Isolimi i vazhdueshëm:

Parashikohet në raste sëmundjesh ngjitëse për arsye shëndetësore; mund të vendoset në kuadrin e ndëshkimit me përjashtim nga aktivitetet e përbashkëta

(nëpërmjet detyrimit për të mos komunikuar me të tjerët), si edhe gjatë hetimeve e procedimentit parandalues nëse autoritetet gjyqësore e shohin të nevojshme. Garantohen ushqimi e uji në sasitë normale si edhe kontrollet mjekësore. Të burgosurit në isolim mund të kenë vizita nga autoritetet politike, gjyqësore, administrative e fetare siç parashikohet në *art. 67 della legge n. 354/75*.

Pezullimi i përkohshëm i rregullave normale të trajtimit:

Ministri i Drejtësisë, në raste të jashtëzakonshme revolte apo situata të tjera të rënda, ka të drejtë të pezullojë në burgun me këto karakteristika aplikimin e rregullave të trajtimit të të burgosurve e të internatëve në mënyrë që të rivendosë rendin dhe sigurinë për një kohë sa më të shkurtër që të jetë e mundur. Ministri i Drejtësisë, po ashtu ka të drejtë të pezullojë plotësisht apo pjesërisht aplikimin e rregullave të trajtimit të të burgosurve e të internatëve për krime të kryera me qëllim terrorizmi apo përbysjeje të rendit demokratik o për krime në bashkëpunim të tipit mafjoz, për të cilat ka fakte që vërtetojnë lidhjet me një organizatë kriminale, terroriste o përmbysëse. Pezullimi parashikon shtrëngimet e nevojshme për të ndaluar lidhjet me organizatat kriminale (vetëm një takim në muaj me familjarët e bashkëjetuesit, me përgjim e regjistrim, përveç takimeve me avokatët; kufizim i shumave të parave e të mallrave të marra nga jashtë, përjashtim nga përfaqësitë, aplikim i kontrollit e

censurës të korrispondecës/postës, kufizim i ajrimit); zgjat katër vjet e mund të zgjatet edhe dy vjet të tjera. Të burgosurit që i nënshtrohen burgimit të veçantë duhet të mbyllen në burgje specifike o sidoqoftë në sektorë të veçantë e të veçuar nga pjesa tjetër e burgut e nën mbikëqyrjen e trupave speciale të policisë së burgjeve. Në kundërshtim me vendimin e pezullimit mund të paraqitet ankesë në gjykatën e mbikëqyrjes së Romës, brenda njëzet ditësh nga data e njoftimit. I burgosuri o internati që i nënshtrohet normativës ligjore *art. 41 bis legge n. 354/1975* (shih fjalorin) mund të marrë pjesë në seancat gjyqësore në distancë, me mënyrat e parashikuara në *art. 146 bis* të normave të zbatimit të kodit të procedurës penale (*c.p.p.*).

Të burgosurat shtatëzëna, lehona e nënat me fëmijë:

Nuk mund të vendoset apo të vazhdojë burgimi parandalues për gratë shtatëzëna o nënat me fëmijë nën gjashtë vjeç përveçse kur ekzistojnë nevoja parandaluese me rëndësi të veçantë. Ekzekutimi i dënimit penal shtyhet për gratë shtatëzëna o për nënat me fëmijë nën një vjeç; është, po ashtu, e mundur të shtyhet ekzekutimi për nënat me fëmijë nën tre vjeç; zbatimi i ndëshkimit me përjashtimin nga aktivitetet e përbashkëta pezullohet për gratë shtatëzëna e për lehonat deri për gjashtë muaj e për nënat që japin gji deri në një vit; të dënuarave e internateve mund t'u jepet leja për t'u kujdesur e për të kuruar jashtë

strukturës fëmijët deri në moshën dhjetëvjeçare, shtatëzënave e nënave me fëmijë u garantohen shërbimet e përshtatshme të mjekëve të specializuar, obstetrikëve e asistentëve të lehonisë. Të burgosurat vendosen në vende të përshtatshme për kushtet e tyre.

Të burgosurit e huaj:

Të burgosurit e huaj kanë të drejtë të kërkojnë që autoritetet konsullore të vendit të tyre të njoftohen për arrestin, të marrin një përmbledhje të normave/rregullave në gjuhën e tyre, të bëjnë telefonata e të kenë takime me ndihmën e një përkthyesi. Kanë të drejtë të ndjekin zakonet e veta ushqimore si edhe ato shpirtërore e fetare. Të burgosurit e huaj që duhet të vuajnë një dënim, apo një pjesë të dënimit, prej nën dy vjetësh, kanë të drejtë të përjashtohen nga Italia për në vendin e tyre. Për dënimet penale mund të aplikohet masa e sigurimit e përjashtimit, që do të ekzekutohet mbas vuajtjes së dënimit. Sidoqoftë, i burgosuri i huaj nuk mund të përjashtohet nëse në vendin e tij mund të persekutohet për arsye raciale, politike, fetare, gjinie, gjuhe apo kombësie, etj. I burgosuri mund të kërkojë që dënimi (prej të paktën gjashtë muajsh) i marrë në Itali të vuhet në vendin ku ka nënshtetësinë; kërkesa përkatëse i drejtohet Ministrisë së Drejtësisë apo, në rast se fakti i gjykuar konsiderohet vepër penale në të dyja vendet, i drejtohet Ministrisë së Drejtësisë të vendit ku ka nënshtetësinë.

Lirimi:

Të burgosurve e internatëve u jepet ndihmë e veçantë në periudhën që paraprin lirimin nga burgu, me anë të shërbimit social e me një program trajtimi që ndihmon në zgjidhjen e problemeve specifike të lidhura me kushtet e jetesës që do të përballojnë. Lirimi kryhet në një datë të caktuar me vendim të veçantë, përveçse kur duhet zbatuar një masë sigurie burgimi. Në momentin e lirimit dorëzohen paratë e depozituara e sendet personale.

Fjalori

Amnistia

Amnistia fshin veprën penale dhe ndalon vuajtjen e dënimit e të ndëshkimeve të tjera lidhur me krimet për të cilat është dhënë (*art. 151 c.p. e 672 c.p.p.*). Amnistia dallohet nga falja apo indulti që ndalojnë vuajtjen e dënimit por nuk shuajnë veprën penale.

Apellante/Apeluesi

Personi i dënuar në shkallë të parë për të cilin është në zhvillim një procedim apeli (gjykim i shkallës së dytë).

Arresti domiciliari/arresti në shtëpi

Është një masë parandaluese personale shtrënguese e marrë ndaj të hetuarve dhe të pandehurve gjatë hetimeve apo gjatë proçesit penal. Zgjatja e arrestit në shtëpi varet nga sa e rëndë është vepra penale përkatëse e nga faza e procedimit (*art. 284 e 303 c.p.p.*). Arresti në shtëpi dallohet nga burgimi në shtëpi sepse është një masë parandaluese (jo dënuese: shënim i përkthyesit).

Articolo 4 bis legge 26 luglio 1975, n. 354, "Normativa e burgjeve"

Parashikon burgimin special që sjell heqjen e mundësisë për të pasur disa privilegjeve (p.sh.

caktimin e punës jashtë burgut, lejet shpërblyese e masat alternative të burgimit) për veprat penale të renditura më poshtë:

- krime të kryera me qëllim terrorizmi apo përmbysjeje të rendit;
- organizim i tipit mafjoz (*art. 416 bis c.p.*);
- skllavërim e tregëti personash (*art. 600, 601, 602 c.p.*)
- sekuestrim personi (*art. 630 c.p.*);
- organizim kriminal për kontrabandën e duhanit (*art. 291 quater D.P.R. 43/1973*);
- organizim për tregëtinë e shpërndarjen e substancave narkotike (*art. 74 D.P.R. 309/1990*);
- çdo lloj krimi që favorizon aktivitetet e organizatave të tipit mafjoz, përveçse kur i dënuari ka bashkëpunuar me organet e drejtësisë e nuk ka lidhje me krimin e organizuar

Assitente sociale/asistent social

Asistenti social është një nënpunës i Ministrisë së Drejtësisë (që dallohet nga ai i Bashkisë o ai i sistemit santar lokal *ASL*), që i përgjigjet Zyrave të ekzekutimit penal të jashtëm (UEPE). Mban lidhjet me familjet e të burgosurve e me organet lokale, ndjek personat që janë nën kujdestarinë e shërbimeve sociale e ka një rol të rëndësishëm në dhënien dhe ekzekutimin e privilegjeve që lejon ligji.

Braccialetto elettronico/ byzylyk elektronik

Kur vendoset masa e arrestit në shtëpi Gjyqtari mund të urdhërojë të ndiqen procedura kontrolli me mjete elektronike nëse i pandehuri është dakort (*art. 275 bis c.p.p.*). në momentin e hyrjes në burg kërkohet miratimi i të burgosurit për ndjekjen e këtij lloji kontrolli (*art. 23 R. E.*).

Cassa delle Ammende/Arka e Fondeve për Riedukimin

Arka e fondeve është një organ juridik i Departamentit për Administrimin e Burgjeve që financon programet për rikthimin në shoqëri të të burgosurve e të familjeve të tyre dhe projektet ndërtimore të burgjeve për përmirësimin e kushteve të jetesës në burg. Të ardhurat që përbëjnë llogarinë e Arkës vijnë nga prodhimtaria e burgjeve, nga ndëshkimet me gjoba e ndëshkime proçesuale të tjera.

Condanato (o definitivo)/i dënuar (o përfundimtar)

I dënuar konsiderohet i pandehuri për të cilin është marrë vendim në formë të prerë me dënim përfundimtar.

Cooperative sociali/ Koooperativat sociale

Këto kooperativa janë shoqëri të krijuara në bazë të *legge 381/1991* e drejtojnë shërbimet sociale, shëndetësore dhe edukative si edhe aktivitete të

ndryshme që kanë si qëllim rikthimin në tregun e punës të personave në disavantazh.

Corte d'assise/Gjykata penale për krime të rënda

Gjykata penale gjykon veprat penale për të cilat ligji parashikon dënimin me burgim të përjetshëm apo me burgim që zgjat jo më pak se njëzetekatër vjet e të gjitha krimet e rënda të përshkruara në *art. 5 c.p.p.* gjykata penale përbëhet nga dy gjyqtarë të titulluar e gjashtë gjyqtarë popullorë.

D.A.P. (Dipartimento dell'amministrazione penitenziaria) / Departamenti për Administrimin e Burgjeve

Është organi përkatës i Ministrisë së Drejtësisë që merret me zhvillimin e veprimtarive lidhur me sistemin e burgjeve.

Detenuto /I burgosuri

Është një term i përgjithshëm që përkufizon personin e mbajtur brenda një strukture burgu për të vuajtur një dënim, por, pa specifikuar situatën konkrete juridike të tij.

Grazia/Falja

Falja mund të jepet për një pjesë apo të gjithë dënimin e caktuar apo e shndërron atë siç parashikon ligji (*art. 174 c.p. e 681 c.p.p.*). Kjo masë faljeje që përcaktohet për një person të veçantë dallohet nga indulti (shih më poshtë)

që bazohet në principe të përgjithshme. Kërkesa për falje, e nënshkruar nga i dënuari o nga një i afërm apo nga avokati, i drejtohet Presidentit të Republikës nëpërmjet Ministrit të Drejtësisë duke paraqitur arsyet e kërkesës.

Imputato/I pandehuri

Është personi i hetuar për të cilin është ngritur një akuzë penale (*art. 60 c.p.p.*).

Indagato/I hetuari

Personi mbi të cilin janë duke u kryer hetime paraprake (*art. 347, comma 2, c.p.p.*).

Indulto/indulti

Është një formë faljeje që mund të jepet për një pjesë apo të gjithë dënimin e dhënë apo e shndërron atë siç parashikon ligji (*art. 174 c.p. e 672 c.p.p.*). Jepet drejtpërdrejtë nga gjyqtari që ka marrë vendimin e dënimit. Në rast se vendimi parashikon marrjen e masave të sigurimit, modifikimet përkatëse të tyre vendosen nga gjyqtari i mbikëqyrjes. Indulti është një masë faljeje e përgjithshme ndërsa falja është individuale.

Internato/internati

Është një person i rrezikshëm për shoqërinë që i nënshtrohet masave të sigurimit brenda një burgu.

Istituto penitenziario/ burgu

Burgu është një vend i mbyllur dhe i izoluar nga shoqëria, ku mbahen të burgosurit. Burgjet janë të drejtuara nga Departamenti për Administrimin e Burgjeve (D.A.P.). Në tipologjinë e burgjeve hyjnë:

- *Casa circondariale*/shtëpi rrethuese ku mbahen personat në pritje të gjykimit apo ato të dënuara me burgim për më pak se pesë vjet (o që u ngelet për të vuajtur më pak se pesë vjet);
- *Casa di reclusione*/ shtëpia e mbylljes ku vuhen dënime më të mëdha;
- *Istituto penale minorile*/ burgu për të miturit nga 14 deri në 18 vjeç;
- Strukturat ku ekzekutohen masat e sigurimit: *Colonie agricole*/kolonitë bujqësore, *Case di lavoro*/ shtëpitë e punës, *Case di cura e custodia*/shtëpitë për kurimin dhe ruajtjen, *Ospedali psichiatrici giudiziari* (OPG)/spitalet psikiatrike gjyqësore që do të zëvendësohen nga strukturat e përshkruara në *comma 2 art. 3 ter d.l. 22.12.2011 n. 211* (i shndërruar me *L. 17.2.2012 n. 9*).

Istituto a Custodia Attenuata per il Trattamento dei Tossicodipendenti (ICATT)/Instituti për burgimin në kushte të lehta për trajtimin e toksikomanëve

Kjo strukturë merret me riaftësimin fizik e psikik të toksikomanëve, nëpërmjet ndjekjes së programeve që parashikojnë veprimtari që kryhen në bashkëpunim me shërbimet publike për trajtimin e toksikomanive,

shërbimin sanitar, sektorin e shërbimeve, vullnetarët dhe bashkësitë terapeutike.

Istituto a Custodia Attenuata per detenute Madri (ICAM)/ Instituti për burgimin në kushte të lehta për nënat.

Në përputhje me kushtet parandaluese normale, gjykatësi mund të vendosë që institutet për burgimin në kushte të lehta të nënave të mbajnë për vuajtjen e dënimeve gratë shtatëzëna e nënat me fëmijë nën shtatë vjeç, ose babain kur nëna ka vdekur ose nuk është absolutisht në gjendje të merret me fëmijët.

Istituto penale minorile/ burgu për të miturit

Burgu për të miturit është instituti ku mbahen të miturit në moshë nga 14 deri në 18 vjeç.

Istituti per l'esecuzione delle misure di sicurezza/ Strukturat ku ekzekutohen masat e sigurimit:

Strukturat ku ekzekutohen masat e sigurimit janë *Colonie agricole*/kolonitë bujqësore, *Case di lavoro*/shtëpitë e punës, *Case di cura e custodia*/shtëpitë për kurimin dhe ruajtjen, *Ospedali psichiatrici giudiziari* (OPG)/spitalet psikiatrike gjyqësore (*art. 62 legge 26 luglio 1975, n. 354*, Rregullat mbi normativën e burgjeve)

Liberazione anticipata/Lirimi para kohe

Të dënuarit me burgim i cili ka dhënë provë positive në pjesëmarrjen e veprimtarisë për riedukim i hiqen 45 ditë për çdo 6 muaj dënimi të vuajtur. I burgosuri i paraqet kërkesën për lirimin para kohe magjistratit të mbikëqyrjes. Në zhargonin/gjuhën e burgut ulja e ditëve të vujatjes së dënimit quhet dhënia e ditëve (*giorni*). Edhe ata që lihen nën kujdestarinë e shërbive sociale apo në kujdestari për raste të veçanta, si p.sh. toksikomania, mund të përfitojnë këtë privilegj kur tregojnë konkretisht një ripërtëritjeje sociale.

Ministero della Giustizia /Ministria e Drejtësisë

Ministria e Drejtësisë është organi qeveritar që merret me administrimin e drejtësisë civile, penale e për të miturit, të burgjeve e të magjistratëve.

Misure cautelari coercitive personali/masa parandaluese shtrënguese personale

Këto masa mund të merren ndaj të hetuarve apo të pandehurve për krime për të cilat parashikohen dënime me burgim për jo më shumë se tre vjet, e vetëm nëse nuk paraqitet rreziku i arratisjes, apo i falsifikimit të provave, ose kryerja e krimeve të tjera. Këto masa përmbledhin: ndalimin e daljes jashtë shtetit, ndalimin apo detyrimin e vendbanimit, arrestin në shtëpi, mbajtjen parandaluese në burg apo në shtëpi për kurim. Përshkruhen në *art. 272-286 c.p.p.*, ndërsa për sa

i përket eksekutimit dhe zgjatjes së masave nga *art. 291-308 c.p.p.*

Misure di sicurezza/Masat e sigurimit

Parashikohen nga nenet e kodit penal: *art. 199 c.p.*

Masat e sigurimit aplikohen:

- për personat që konsiderohen të rrezikshëm për shoqërinë;
- kur është kryer një vepër penale, apo është e mundur të jetë kryer siç parashikohet nga *art. 49 c.p.*, ose kur ka marrëveshje o nxitje për kryerjen e një vepre penale;
- kur mendohet se është e mundur kryerja e fakteve që ligji i përshkruan si vepra penale.

Këto masa përcaktohen nga gjyqtarit në vendimin e dënimit. Nuk kanë rol vetëm në kufizimin e rrezikshmërisë shoqërore, por edhe në riedukimin me qëllim rikthimin e personit në rrjetin shoqëror. Zgjatja është e papërcaktuar: ligji përshkruan periudhën minimale dhe i përket gjyqtarit, në përfundim të kësaj periudhe, të vendosë nëse personi është ende i rrezikshëm për shoqërinë. Masat e sigurimit janë personale kur kufizojnë lirinë individuale (me burgim ose pa burgim), janë pasurore kur prekin pasurinë e personit (kaucioni për sjellje të mirë, e konfiskimi).

Masat e sigurimit me burgim janë:

- caktimi në një koloni bujqësore, apo shtëpi pune (për kriminelët e zakonshëm, profesionistë o me prirje kriminale);

- shtrimi në shtëpitë e kurimit dhe ruajtjes (për të dënuarit me dënim të shkurtuar për sëmundje mendore apo për mvartësia kronike nga alkooli apo substancat narkotike);
- shtrimi në spital psikiatrik gjyqësor (për të pandehurit për të cilët ka pushuar çështja penale për arsyet e radhitura më sipër; nuk aplikohet për të miturit);
- vendosja në shkollën e riedukimit gjyqësor për të miturit

Masat e sigurimit pa burgim janë:

- liria e kontrolluar (parashikon që personi të ketë detyrimisht një punë apo të kërkojë punë, dhe hyrjen në shtëpi detyrimisht brenda një ore të caktuar);
- ndalimin e qëndrimit (në një apo më shumë bashki ose në një apo më shumë provinca)
- ndalimi i hyrjes në lokale publike ku shiten apo shpërndahen pije alkoolike;
- përjashtimi i të huajit nga shteti italian.

Magjistrati i mbikëqyrjes kontrollon ekzekutimin e masave personale të sigurimit; verifikon nëse personi është i rrezikshëm për shoqërinë; jep apo tërheq deklaratën e prirjes kriminale, të përsëritshmërisë apo të profesionalizmit kriminal. Kundër këtyre vendimeve mund të paraqitet apel pranë Gjykatës së mbikëqyrjes nga prokurori, i intersuari apo avokati i i tij (*art. 679 e 680 c. p. p.*).

Notificazione/Njoftimi

Veprimi me të cilin oficeri gjyqësor apo një person i caktuar në bazë të ligjit (p.sh. policia gjyqësore) i paraqet dhe i bën të njohur zyrtarisht një akt marrësit nëpërmjet dorëzimit të një kopje të njejtë me origjinalin. Marrësi, me pranimin e aktit, duhet të firmosë një kopje (*relata di notifica*) si provë marrjeje që oficeri gjyqësor i dërgon autoritetit përkatës.

Patrocinio a spese dello Stato ("gratuito patrocinio") /Mbrojtje me shpenzimet e shtetit (mbrojtje falas)

Për personat që nuk janë në gjendje ekonomike të përshtatshme njihet e drejta për t'u mbrojtur me shpenzimet e shtetit përpara një gjykatësi penal, si edhe në procedimentet e mbikëqyrjes.

Pena pecuniaria/Ndëshkim me para

Është një nga format e ndëshkimit që gjyqtari i jep të dënuarit (forma tjetër është burgimi). Dallohet në gjobë për veprat penale (*multa*) e në gjobë për kundravajtje (*ammenda*). Është edhe një masë që mund të zëvendësojë burgimin e shkurtër të parashikuara nga *legge 24 novembre 1981, n. 689* mbi "Depenalizimin dhe modifikimet e sistemit penal" (*art. 53 e seguenti*). Ndëshkimi me para mund të ekzekutohet me sistem kështesh apo duke u shndërruar në burgim.

Pericolosità sociale/Rrezikshmëria për shoqërinë
Personi që ka kryer vepra penale apo që ka mundësi të kryejë përsëri vepra penale konsiderohet i rrezikshëm për shoqërinë (*art. 203 c.p.*).

Permesso di soggiorno/Lejeqëndrimi
Lejeqëndrimi është autorizimi administrativ që i jepet të huajit nga shtetit italian për të qëndruar në Itali. Kërkesa e lejeqëndrimit duhet paraqitur brenda tetë ditësh pune (që nuk llogarisin të shtunën e të djelën) nga data e hyrjes në territorin italian tek Sporteli Unik për Imigracionin (*Sportello Unico per l'Immigrazine*) kur është lëshuar autorizimi për bashkim familjar apo punë, përndyshe mund të paraqitet në Kuesturë.

Perquisizine personale/Kontrolli personal.
Të burgosurit mund të kontrollohen për arsye sigurie duke respektuar plotësisht të drejtat e personit (*Art. 34 OP e art. 74 Reg*).

Pubblico Ministero/Prokurori
Është magjistrati që njoftohet për krimin, ndërmerr veprimin penal, përfaqëson akuzën në proçeset penale dhe propozon fazën e ekzekutimit të dënimit.
Recidiva/ Përsëritja kriminale
Përsëritja kriminale është gjendja personale e atyre që pasi janë dënuar për një vepër penale me vendim të formës së prerë, kryejnë një tjetër vepër penale. Përbën një nga të ashtuquajturat rrjedhoja penale të dënimit

dhe përbën një ndër rrethanat specifike të fajtorit. Përsëritja kriminale ka si rrjedhim të mundshëm rëndimin e ndëshkimit.

Reclusione/burgimi

Burgimi është forma e ndëshkimit për ata që janë dënuar për vepra penale. Mund të zgjasë nga 15 ditë deri në 24 vjet dhe vuhet në burg. Ndëshkimi me burgim mund të shndërrohet në ndëshkim me para, kur është e mundur.

Rateizzazione della pena pecuniaria/Ndëshkimi me para me këste

Në rast ndëshkimi me para apo shndërrimi të një dënimi me burgim në ndëshkim me para, e kur paraqiten situata për të cilat nuk është e mundur përkohësisht shlyerja e shumës së caktuar, është e mundur të kryhet shtyrja e pagesës o shlyerja nëpërmjet kësteve, me kërkesë të të dënuarit (*art. 660, 3°c, c.p.p.*). Magjistrati i mbikëqyrjes pasi ka vlerësuar gjendjen ekonomike të të dënuarit, mund të vendosë që pagesa të kryhet me jo më shumë se tridhjetë këste mujore (*art. 133 ter c.p.*). Ndëshkimi me para mund të shndërrohet në liri të kontrolluar apo në punë si shkëmbim.

Riabilitazione/Rehabilitimi

Rehabilitimi është një privilegj i njohur me ligj (*artt. 178 e seguenti c.p. e art. 683 c.p.p.*) që shuan të gjitha efektet e

një dënimi penal. Rehabilitimi njihet të paktën tre vjet mbasi ka përfunduar vuajtja e dënimit (në burg, me masë alternative, apo e shuajtur nëpërmjet indultit o për privilegje të tjera). Duhet të kalojnë të paktën tetë vjet në rast përsëritje kriminale (*art. 99 c.p.*) e dhjetë vjet në rast se i dënuari është deklaruar kriminel i zakonshëm, profesionist apo me prirje kriminale. Për të përfituar rehabilitimin, i dënuari që ka pësuar masë sigurimi, duhet të ketë përfituar revokimin e saj, e të ketë përmbushur detyrimet civile që rrjedhojnë nga vepra penale, d.m.th. të ketë dhënë dëmshpërbimin. Për të pasur rehabilitimin duhet të mbahet një qëndrim i rregullt, jo vetëm duke mos kryer vepra penale, por edhe duke mbajtur një sjellje korrekte e të përgjegjshme. Kërkesa për rehabilitim i paraqitet gjykatës së mbikëqyrjes që vendos nëpërmjet një jurie.

Ricorrente/apeluesi në Kasacion

Është i pandehuri që është dënuar e që paraqet apel në Gjykatën e Kasacionit.

Ricorso per cassazione/Apel për kasacion (anullim)

I pandehuri apo prokurori mund të kërkojnë apel në Gjykatën e Kasacionit për të kundërshtuar vedimin e marrë në gjykimin e shkallës së dytë apo vendimin e pakundërshtueshëm të "akuzës e paqëndrueshme" (*art. 607 c.p.p*). Prokurori, i interesuari e në raste të veçanta edhe administrata e burgjeve mund të kërkojnë anullimin e urdhëresave të Gjykatës së mbikëqyrjes

(*art. 71 ter della legge 26 luglio 1975, n. 354*, "Rregullat mbi normativën e burgjeve"). Arsyet për të cilat mund të paraqitet kërkesë për kasacion përshkruhen në *art. 606 c.p.p.* dhe kanë të bëjnë veçanërisht, për sa i përket Gjykatës së mbikëqyrjes me parregullsi ligjore apo me parregullsi në motivacionin e urdhëresave.

Rinvio facoltativo dell'esecuzione della pena/ Shtyrje e padetyrueshme e ekzekutimit të dënimit

Ekzekutimi i një vendimi mund të shtyhet (*art. 147 c.p. e art. 684 c.p.p*) nëse:

- është paraqitur kërkesë për falje;
- personi i dënuar me kufizim të lirisë është në gjendje të rëndë sëmundjeje fizike;
- personi i dënuar me kufizim të lirisë është nënë me fëmijë nën tre vjeç.

Rinvio obbligatorio dell'esecuzione della pena/Shtyrje e detyrueshme e ekzekutimit të dënimit

Ekzekutimi i dënimeve me burgim, me gjysëmburgim e me liri të kontrolluar duhet të shtyhet (*art. 146 c.p. e art. 684 c.p.p.*) kur i dënuari është:

- grua shtatëzënë;
- nënë me fëmijë nën një vjeç
- person me AIDS o me sëmundje veçanërisht të rëndë, e papërputhshme me mbajtjen në burg, sidoqoftë kur kurat nuk kanë efekt.

Soggetti che operano all'interno dell'istituto penitenziario con i quali ogni detenuto può chiedere di conferire/Personat që punojnë brenda burgut me të cilët i burgosuri mund të kërkojë të komunikojë:

- **drejtori o nëndrejtorat** e burgut, që janë përgjegjës për drejtimin e administrimin e rregullt të burgut.
- **komandanti, inspektorët, nëninspektorët, asistentët, agjentët e policisë së burgjeve** që garantojnë rendin e ruajnë sigurinë brenda burgut, marrin pjesë në aktivitetet e vrojtimit e të trajtimit riedukativ si edhe kryejnë shërbime transferimi;
- personeli i policisë së burgjeve që drejton **zyrën e regjistrimit** (*ufficio matricola*), që kryen veprimet e regjistrimit e të lirimit të të burgosurve, organizon pjesëmarrjen në seancat gjyqësore, marrjen në pyetje, takimet me avokatët e me hetuesit e pranon kërkesat ("*domandine*") që i burgosuri i paraqet drejtorit të burgut;
- **përgjegjësi i edukimit** dhe edukatorët që përgatisin, organizojnë e caktojnë aktivitetet shkollore, të punës, e të veprimtarive kulturore, zbavitëse e sportive. Janë pjestarë të grupit të vrojtimit e trajtimit.
- **operatorët e *Ser.T*** (shërbimi për toksikomaninë) zhvillojnë aktivitetet e asistencës për të burgosurit me probleme toksikomanie apo alkoolizmi;
- **asistentët social** që në kuadrin e Zyrës së ekzekutimit penal të jashtëm (UEPE) marrin pjesë në aktivitetet e vrojtimit e të trajtimit nëpërmjet

kontrollit të marrëdhënieve të të burgosurve me ambjentin e jashtëm për vlersimin e privilegjeve ligjore (masat alternative) apo daljen nga burgu, duke kryer po ashtu edhe veprime në favor të familjeve të të burgosurve;

- **assistentët vullnetarë** marrin pjesë në aktivitetet e trajtimit edhe me organizata;
- **kapelani apo kleriku i një feje;**
- **psikologu, psikiatri, përgjesi shëndetësor, mjekët e infermierët**
- **përgjegjësi administrativ-llogaritar dhe llogaritarët.**

Soggetti che operano all'esterno dell'istituto ai quali il detenuto può rivolgersi/Personat jashtë burgut me të cilët i burgosuri mund të kërkojë të komunikojë:

- **përgjegjësi krahinor** (*provveditore regionale*) për administrimin e burgjeve që programon aktivitetet e trajtimit, koordinon aktivitetet në lidhje me punën, formimin profesional, aktivitetet shkollore, sportive e kulturore dhe është përgjegjës ndër të tjera për transferimet përkatëse brenda zonës;
- **Autoriteti Gjyqësor** që merret me procesin;
- **Magjistrati i mbikëqyrjes** që kontrollon organizimin e strukturave të parandalimit e të burgimit, ka detyrën të vendosë për kërkesat e paraqitura nga të burgosurit për përfitimin e masave alternative, mbi ankesat në kundërshtim me masat e administratës së burgjeve, mbi kërkesat për

leje dhe autorizime e për anullimin e masave të sigurimit;

- **Gjykata Evropiane** për të drejtat e njeriut të cilës i dënuari mund t'i drejtohet vetëm pasi ka shpenzuar të gjitha instrumentat juridiksional tek gjyqtarët e shtetit italian (brenda gjashtë muajsh nga marrja e formës së prerë të vendimit), kur mendohet se janë shkelur normat e Konventës Evropiane për të drejtat e njeriut të 4.11.1950;
- **Presidenti i Republikës** të cilit mund t'i kërkohet falja apo shndërrimi i ndëshkimit. Kërkesa për falje i duhet paraqitur Ministrit të Drejtësisë nëpërmjet magjistratit të mbikëqyrjes.
- Garanti i të drejtave të personave që u është hequr liria personale, në rastet kur kjo figurë është caktuar në zonën përkatëse të burgut; Garanti sensibilizon publikun mbi temat e të drejtave të njeriut e mbi qëllimin riedukativ të vuajtjes së dënimit.

Sopravvitto/ Ushqime suplementare

Produktet ushqimore që të burgosurit mund të blejnë me shpenzimet e veta brenda masës së caktuar.

Sospensione condizionale della pena/Pezullimi i kushtëzuar i ndëshkimit

Nëse gjykatësi dënon me burgim o arrest për një kohë jo më të gjatë se dy vjet, mund të vendosë edhe t'a pezullojë ekzekutimin. Nëse për pesë vjet (ose dy vjet në rast kundravajtjeje) i dënuari nuk do të kryejë vepra

të tjera penale, do t'i nënshtrohet detyrimeve të imponuara e nuk do të dënohet përsëri, vepra penale do të fshihet. Në rast të kundërt, pezullimi do të revokohet e dënimi duhet të ekzekutohet. Nëse i dënuari është nën moshën 18 vjeçare, pezullimi i kushtëzuar mund të jepet edhe për ndëshkimet deri në tre vjet burgimi o arresti. Nëse i dënuari ka moshën nga 18 deri në 21 vjeç, apo mbi 70 vjeç, dënimi që mund të pezullohet nuk mund të jetë më i gjatë se dy vjet e gjashtë muaj. Pezullimi i kushtëzuar mund të vendoset kur gjykatësi mendon se i fajtori nuk do të kryejë vepra të tjera penale, nëse nuk ka dënime me burgim të mëparshme e nëse nuk i janë imponuar masa sigurimi personale për rrezikshmëri shoqërore. Pezullimi i kushtëzuar bazohet në *art.i 163-168 c.p.*

Spese di giustizia/Shpenzimet ligjore

Janë ato shpenzime që bëhen për proçesin gjyqësor e për mbajtjen në burg, që janë në ngarkim të të pandehurit kur dënohet. Mund të eliminohen nëse i dënuari nuk është në gjendje ekonomike për të paguar e kur mban një sjellje korrekte.

Trattamento/trajtimi

Ndaj të burgosurve dhe internatëve duhet realizuar një trajtim riedukativ që të ketë për qëllim rikthimin e tyre në shoqëri. Trajtimi duhet realizohet duke pasur parasysh karakteristikat vetjake të personit, duhet të jetë njerëzor e në respekt të dinjitetit të personit.

Trajtimi zhvillohet sidomos duke u bazuar tek arsimimi, puna, feja, aktivitetet kulturore, zbavitëse e sportive e duke lehtësuar marrëdhëniet me jashtë e me familjen.

Tribunale di sorveglianza/Gjykata e mbikëqyrjes

Gjykata e mbikëqyrjes ka kompetencë territoriale në rrethin përkatës të Gjykatës së Apelit (shkallë e dytë e gjykimit). Është një trup gjykues që mund të përbëhet nga magjistratë, ekspertë në psikologji, shërbimet sociale, pedagogji, psikiatri e kriminologji klinike, si edhe nga nga pedagogë të shkencave kriminologjike. Vendimet e marra nga Gjykata e mbikëqyrjes vendosen nga një trup gjykues i përbërë nga katër persona: presidenti, një magjistrat i mbikëqyrjes e dy ekspertë. Gjykata e mbikëqyrjes mund të vendosë si gjyqtar i shkallës së parë ashtu edhe si gjyqtar i shkallës së dytë (i apelit). Në shkallë të parë mund të vendoset mbi dhënien apo revokimin e kujdestarisë në provë tek shërbimet socilae, të burgimit në shtëpi, të gjysëmlirisë, të lirimit me kusht; mbi shtyrjen e detyrueshme apo të padetyrueshme të ekzekutimit të dënimit me burgim; mbi kërkesat për rehabilitm. Në shkallë të dytë, në pozitën e një gjyqtari të apelit, gjykata vendos mbi kundërshtimet e paraqitur ndaj vendimeve të pushimit të çështjeve penale të shoqëruara nga aplikimi i masave të sigurimit të marra nga gjykatat penale e kundër urdhëresave të seancave të mbajtura nga magjistrati i mbikëqyrjes mbi lejet, lirimet e parakohshme,

përjashtimi nga shteti italian, e për disa vendime të marra nga administrata e burgjeve. Gjykata e mbikëqyrjes së Romës është kompetente për të vendosur në lidhje me ankesat kundër vendimeve të marra në bazë të *art. 41 bis comma 2 legge n. 354 del 1975*. Në kundërshtim me vendimet e marra nga Gjykata e mbikëqyrjes mund të paraqitet apel në Kasacion.

Tribunale penale/Gjykata penale

Gjykata penale kur përfaqësohet nga trupi gjykues (tre gjyqtarë) gjykon krimet e rënda të renditura në *art. 33 bis c.p.;* kur përfaqësohet vetëm nga një gjykatës (monocratico) gjykon krimet më të lehta siç parashikohen nga a*rt. 33 bis c.p.*

Ufficio di esecuzione penale esterna (Uepe)/ Zyra e eksekutimit penal të jashtmëm

Zyra e eksekutimit penal të jashtmëm (Uepe), e krijuar në bazë të ligjit për reformën e burgjeve *L. n. 354 del 1975*, është një zyrë periferike e Ministrisë së Drejtësisë, Departamenti për Administrimin e Burgjeve. Heton me anë të shërbimeve sociale mbi kërkesat e Gjykatës së mbikëqyrjes për të njohur situatën reale personale, familjare, të punës të personave që i nënshtrohen një dënimi apo masave të sigurimit, edhe për të vendosur aplikimin e masave alternative ndaj burgimit, apo mbi masat shtrënguese të lirisë, ose mbi programin e trajtimit.

Ufficio di sorveglianza/Zyra e mbikëqyrjes

Zyra e mbikëqyrjes ka kompetencë territoriale që mbulon disa rrethe. Rrethi është zona përkatëse e një gjykate. Zyra e mbikëqyrjes përbëhet nga një apo më shumë magjistratë. Seicilit prej tyre u caktohen burgjet dhe të dënuarit që duhet të ndjekin. Zyra e mbikëqyrjes është organ monokratik/ me një gjyqtar. Magjistrati i mbikëqyrjes ka detyrën të kontrollojë organizimin dhe strukturat e parandalimit e të burgimit. Magjistrati i mbikëqyrjes është përgjegjës për aprovimin e programit të trajtimit riedukativ të seicilit prej të burgosurve (që administrata e burgjeve është e detyruar të përgatisë), për dhënien e lejeve, autorizimin për punë jashtë burgut e për të kryer vizita mjekësore, shtrimin në spital o shtrimin për arsye psikike, të vendosë lirimin e parakohshëm e shuarjen e borxhit për shpenzimet ligjore e qëndrimin në burg. Ligji detyron magjistratin e mbikëqyrjes të shkojë shpeshherë në burg e të dëgjojë të gjithë të burgosurit që kërkojnë të flasin me të, i jep po ashtu detyrën që të shqyrtojë ankesat e paraqitura nga të burgosurit përsa i përket masave disiplinore të vendosura nga administrata e burgut apo për arsye të tjera. Autorizon telefonatat e të burgosurve e kontrollin e letërkëmbimit. Po ashtu, me sugjerimin e drejtorisë së burgut, autorizon hyrjen e personave të jashtëm, si vullnetarët apo ata që marrin pjesë në aktivitetet e formimit apo të punës së të burgosurve. Magjistrati i mbikëqyrjes vendos edhe mbi pezullimin apo shtyrjen e ekzekutimit të dënimit,

kontrollon ekzekutimin e masave alternative ndaj burgimit (p.sh. kujdestarinë në provë tek shërbimet sociale, burgimin në shtëpi, gjysëmlirimin). Vendos mbi rishqyrtimin e rrezikshmërisë shoqërore dhe si rrjedhim aplikimin, ekzekutimin e revokimin e masave të sigurimit të vendosura nga Gjykata normale. Vlerëson kërkesat mbi shndërrimin apo pagesën me këste të dënimeve me para. Vendos mbi përjashtimin nga Italia e të burgosurve të huaj e zbatimin e lirisë së kontrolluar. Jep vlerësimin mbi kërkesat e proposimet për falje.

Volontari in carcere/Vullnetarët në burg

Një vullnetar hyn në burg për të dhënë kontributin e tij në veprimataritë riedukative e për rikthimin e të burgosurve në shoqëri (*art. 17 e 78 O.P.*). *Art. 17* i jep mundësinë një personi apo një organizate t'i paraqesë Drejtorisë së burgut një projekt që mendohet i dobishëm për afrimin e bashkësisë së të burgosurve me shoqërinë e lirë. Ndërsa *art. 78*, parashikon lejimin e hyrjes së vullnetarëve në burg për të ofruar mbështetje morale e për të ndihmuar në rikthimin në shoqëri.

Burimet juridike

Principet e kushtetutës

Art.2: garanton të drejtat e pacënueshme të njeriut edhe pse i burgosur.

Art. 3 comma 1: siguron principin e barazisë formale, si në trajtimin në burg, si në procedimentin mbikëqyrës. *Comma 2* udhëzon mbi barazinë konkrete e substanciale.

Art.10: i parashkruan normativës juridike italiane t'i përshtatet normativës së të drejtës ndërkombëtare.

Art. 11: i dikton shtetin italian të heqë dorë nga sovraniteti i tij në favor të Bashkimit Evropian në fushën e drejtësisë.

Art. 13 comma 2: vendos mbi riservën jurikdisionale për të cilën vetëm një veprim i justifikuar i autoriteteve gjyqësore mund të heqë apo të kufizojë lirinë personale.

Art.24 comma 2: garanton të drejtën e pacënueshme për t'u mbrojtur në çdo moment apo shkallë të procedimentit, edhe në rast procedimenti mbikëqyrës

Coma 3 i siguron personave që nuk janë në gjendje ekonomike mënyrën për t'u mbrojtur, edhe gjatë procedimentit të mbikëqyrjes.
Comma 4 dikton që të parashikohet me ligj rishqyrtimi i vendimeve të dënimive të padrejta.

Art.25 comma1: garanton që kompetenca e gjyqtarit të jetë e vendosur paraprakisht nga ligji me kritere objektive.
Coma 2 parashikon që asnjeri nuk mund të dënohet përveçëse duke u bazuar në një ligj që ka hyrë në fuqi përpara se të ndodhë ngjarja.
Comma 3 parashikon që asnjeri nuk mundet t'i nënshtrohet masave të sigurisë përveçse në rastet e parashikuara me ligj.

Art. 27 comma 2: dikton principin për të cilin një i hetuar konsiderohet i fajshëm vetëm kur dënimi ka marrë formë të prerë.
Comma 3 vendos që ndëshkimi nuk mund të jetë çnjerëzor e duhet të ketë për qëllim riedukimin e të dënuarit.

Art. 35 e 36 mbrojnë principet lidhur me punën në të gjtha format në të cilat zhvillohet, edhe kur zhvillohet nga të dënuarit.

Art. 79 specifikon procedurën e krijimit të ligjeve lidhur me amnistinë dhe indultin.

Art. 87 i njeh Presidentit të Republikës së Italisë pushtetin për të dhënë falje apo shndërrimin e dënimit.

Art. 101 dikton që drejtësia zbatohet në emër të popullit dhe që gjyqtarët i përgjigjen vetëm ligjit.

Art. 104 garanton autonominë dhe indipendencën e magjistraturës.
Art. 111 garanton një proçes të drejtë, të kryer në kohra të arsyeshme, të bazuar në ligj, në ballafaqimin e palëve, në kushte të barabarta e përpara një gjyqtari të paanshëm.

Art. 117 dikton se pushteti legjislativ ushtrohet duke respektuar Kushtetutën e detyrimet që rrjedhin nga normativa e Bashkimit Evropian e ndërkombëtar.

Burimet ligjore mbikombëtare.

Deklarata universale e të drejtave të njeriut e aprovuar nga Asablea gjenerale e Kombeve të Bashkuara në New York më 10 dhjetor të 1948.

Rregullat evropiane mbi burgjet që janë ritheksuar në Rakomandimin *R(2006)2* të Komitetit të Ministrave të Shteteve antarë të Bashkimit Evropian.

Konventa evropiane për mbrojtjen e të drejtave e të lirive themelore të njeriut, që është përpiluar në Romë më 4 nëntor të 1950 dhe ka hyrë në fuqi në Itali më 4 gusht 1955 L. 881

Zgjidhje e Rakomandime të Komitetit të ministrave të Këshillit të Evropës shteteve antarë të BE-së, si R(1999)22 lidhur me mbipopullimin, *R(2006)13* mbi burgimin parandalues, *R(2010)1* mbi lirimin me kusht, *R(2012)12* mbi të burgosurit e huaj.

Standartet e Komitetit për parandalimin e Torturës e të ndëshkimeve e trajtimeve çnjerëzore e përçmuese (*CPT*) të publikuara në 2006 e që përmbajnë vërejtjet thelbësore e të përgjithshme të raporteve të këtij Komitetit (*CPT*).

Ligjet kombëtare normale

Legge 26 luglio 1975 n. 354 "Normativa e burgjeve dhe e zbatimit të masave të heqjes e kufizimit të lirisë"

Legge 10 o7obre 1986 n. 662 (iquajtur ***legge Gozzini***) "Modifikime të ligjit mbi normativën e burgjeve dhe zbatimit të masave të heqjes e kufizimit të lirisë"

Legge 27 maggio 1998 n. 165 (i quajtur ***Simeone-Saraceni***) "Modifikime të *art. 656* Kodi i procedurës penale -*C.c.p. e të legge 26 luglio 1975 n. 354* modifikime të mëtejshme".

Legge 5 dicembre 2005 n. 251 (i quajtur ***legge ex Cirielli***) "Modifikime të kodit penal-*C.p.* e të *legge 26 luglio 1975 n. 354* mbi elementët lehtësues të përgjithshëm, të përsitshmërisë, të gjykimit krahasues të kushteve të veprimive penale për ata që përsëritin veprimtarinë kriminale, për krimet lidhur me fajde, për skadimin o anullimin e veprimeve penale.

Kodi penal – *C.p.*: në fuqi më 1930

Kodi i procedurës penale - *C.c.p.:* i vënë në fuqi me *DPR n. 447 1988*

Teksti Unik mbi Imigracionin – *TUI* i aprovuar me *DPR n.286 1998* "Teksti unik me dispozitat mbi imigracionin dhe normat mbi kushtet për të huajt."

Legge n. 193 del 2000 (i quajtur ***Legge Smuraglia***) "Normat që rregullojnë aktivitetet e punës së të burgosurve".

Legge n. 40 del 2001 (i quajtur ***Legge Finocchiaro***) "Masat alternative të burgimit në mbrojtje të lidhjeve midis të burgosurave dhe fëmijëve të mitur"

DPR n. 230 del 2000 "Rregullore që përmban normativën e burgjeve e atë mbi masat e heqjes e kufizimit të lirisë"

Redaktuar e shtypur nga Qendra e Riproduktimit
të Departamenti për Administrimin e Burgjeve

Largo Luigi Daga, 2
ROMA
Botimi I: janar 2013